



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.854/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Afijete Sada Gllgjani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrri Kaltrina Hyseni nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.854/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Kaltrina Hyseni, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në komunën e Vushtrrisë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2727B/01R, 2727B/02D, 2702X/01R, 2702X/02R, 2702X/03R, 2702X/04R, 2702X/05D, 2702B/01R, 2702B/02R, 2702B/03R, 2702B/04R, 2702B/05D, 2704B/01R, 2704B/02R, 2704B/03R, 2704B/04R, 2704B/05R, 2704B/06R, 2704B/07R, 2704B/08R, 2704B/09R, 2704B/10R, 2704B/11R, 2704B/12R, 2704B/13R, 2704B/14D, 2701B/01R, 2701B/02R, 2701B/03R, 2701B/04R, 2701B/05R, 2701B/06R, 2701B/07R, 2701B/08R, 2701B/09R, 2701B/10R, 2701B/11R, 2701B/12R, 2701B/13R, 2701B/14D, 2715B/01D, 2713B/01R, 2713B/02R, 2713B/03R, 2713B/04R, 2713B/05D, 2712B/01R, 2712B/02R, 2712B/03D .

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.854/2021 të paraqitur nga Kaltrina Hyseni, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2727B/01R, 2727B/02D, 2702X/01R, 2702X/02R, 2702X/03R, 2702X/04R, 2702X/05D, 2702B/01R, 2702B/02R, 2702B/03R, 2702B/04R, 2702B/05D, 2704B/01R, 2704B/02R, 2704B/03R, 2704B/04R, 2704B/05R, 2704B/06R, 2704B/07R, 2704B/08R, 2704B/09R, 2704B/10R, 2704B/11R, 2704B/12R, 2704B/13R, 2704B/14D, 2701B/01R, 2701B/02R, 2701B/03R, 2701B/04R, 2701B/05R, 2701B/06R, 2701B/07R, 2701B/08R, 2701B/09R, 2701B/10R, 2701B/11R, 2701B/12R, 2701B/13R,

2701B/14D, 2715B/01D, 2713B/01R, 2713B/02R, 2713B/03R, 2713B/04R, 2713B/05D, 2712B/01R, 2712B/02R, 2712B/03D, një numër i konsideruar i votuesve kanë votuar dhe votat e tyre nuk figurojnë në këto vendvotime dhe kërkon nga PZAP që të rinumërohen këto vendvotime.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Kaltrina Hyseni, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet e cekura më lartë.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të theksuara në apel, gjë që këto pretendime për Panelin nuk janë të bazuara për faktin se parashtruesja e apelit nuk ka ofruar dëshmi, formular apo ndonjë deklaratë që do të dëshmonte se pretendimet e për pa rregullsi në vendvotimet përkatëse janë të bazuara.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.854/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesues i Panelit
Bërim Ademi**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.